



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 135/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurave të prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-88835-03-02-2021 me objekt: “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh”, me fond limit 81,666,600 lekë pa TVSh, parashikuar për tu zhvilluar me datë 07.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
- Ankimues:** “Beqiri” ShPK  
Adresa: Rruga “Todi Shkurti”, Lagjja “15 Tetori”, Pallati 10 katësh, Fier.
- Autoriteti kontraktor:** Bashkia Gramsh.  
Adresa: Bulevardi “10 Korriku”, Gramsh.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këto procedura prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me to, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesa pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.03.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedurat e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-88835-03-02-2021 me objekt: “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh”, me fond limit 81,666,600 lekë pa TVSh, parashikuar për tu zhvilluar me datë 07.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se operatori ekonomik “Beqiri” ShPK ka paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor në datë 09.03.2021, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 16.03.2021 më anë të shkresës nr. 948/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës të operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë. Operatori ekonomik ankimues pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor në datë 19.03.2021 nëpërmjet shërbimit postar, por nuk ka paraqitur asnjë provë rreth këtij fakti.

II.4. Në datën 24.03.2021 operatori ekonomik ankimues “Beqiri” ShPK ka paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumenteve të

tenderit, me të njëjtin objekt ankese si pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës,

#### **Arsyeton**

III.1. Në datën 03.03.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedurat e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-88835-03-02-2021 me objekt: “*Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh*”, me fond limit 81,666,600 lekë pa TVSh, parashikuar për tu zhvilluar me datë 07.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

III.1.1. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se operatori ekonomik “*Beqiri*” ShPK, ka paraqitur ankese pranë autoritetit kontraktor në datë 09.03.2021, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurave të mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Në datën 16.03.2021 më anë të shkresës nr. 948/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë. Operatori ekonomik ankimues pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor, në datë 19.03.2021, nëpërmjet shërbimit postar, por nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt.

III.1.3. Në datën 24.03.2021 operatori ekonomik ankimues “*Beqiri*” ShPK ka paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumenteve të tenderit, për procedurat e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar: “*1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

*1.1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.1.5. Në rastin konkret, referuar ankesës të operatorit ekonomik ankimes, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se operatori ekonomik “Beqiri” ShPK ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor në datën 09.03.2021, në lidhje me modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit si më sipër cituar.

Referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 948/2 prot., datë 16.03.2021, të cilën operatori ekonomik e ka bashkëlidhur ankesës së tij pranë KPP, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës të operatorit ekonomik “Beqiri” ShPK duke e pranuar pjesërisht atë. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë KPP ka deklaruar se ka marrë dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së tij në datë 19.03.2021, por nuk ka paraqitur asnjë provë për ta faktuar këtë pretendim. Në nenin 63 pika 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet përkatësisht se “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Referuar datës së dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, KPP konstaton se ankimesi i operatorit ekonomik “Beqiri” ShPK është paraqitur jashtë afatit 10 ditor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ky i fundit nuk legjitimohet *ratione temporis*. Konkretisht, referuar legjislacionit si më sipër cituar, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në datën 09.03.2021 dhe në datën 24.03.2021 ka depozituar ankesën pranë KPP, ndërkohë që autoriteti kontraktor ka pasur detyrimin ligjor si më sipër përcaktuar që të shqyrtojë ankesën dhe të merrte një vendim të arsyetuar brenda 3 ditëve pas marrjes së ankesës, çka do të thotë se referuar dispozitave ligjore sa më sipër cituar konkretisht nenit 63 pika 1/1, autoriteti

kontraktor duhet ti kthente përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda datës 11.03.2021. Mosrespektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorit ekonomik ankimues, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 6 të LPP-së. Sqarojmë se operatori ekonomik bazuar në nenin 63 të LPP pika 6 ku përcaktohet se “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor[...], duhet të vazhdonde me paraqitjen e ankesës në shkallën tjetër më të lartë të shqyrtimit të ankesave, pasi legjislacioni në fuqi për prokurimin publik përcakton që nëse autoriteti kontraktor nuk përgjigjet brenda 3 ditëve, atëherë operatori mund të drejtohet pranë KPP, gjë të cilën nuk e ka respektuar dhe nuk e ka ezauruar brenda afateve të parashikuara nga LPP, duke dështuar të dorëzojë ankesat në KPP brenda 10 ditëve nga përfundimi i afateve ligjore të ankimimit në autoritetin kontraktor, sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, si edhe duke përbërë shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Sa më sipër, K.P.P konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 24.03.2021 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (*ndër to dhe ai i ankimimit*), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit.

III.1.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin, që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim

administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Beqiri” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-88835-03-02-2021 me objekt: “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh”, me fond limit 81,666,600 lekë pa TVSh, parashikuar për tu zhvilluar me datë 07.04.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 463 Protokoli, Datë 24.03.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**